



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 116 - Shkurt 2013 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Prezantimi i profilit të Planit Zhvillimor Komunal





Përmbajtja:

Pritet të realizohen dhjetëra projekte gjatë këtij viti	3
U prezantua Plani Zhvillimor i Komunës së Malishevës.....	3
Komuniteti RAE, të integruar mirë në shoqëri.....	5
Komuna dhe IKSHP diskutojnë për masat parandaluese kundër etheve hemorragjike	5
U prezantua draft plani hapësinor për “Ujëvarat e Mirushës”	6
Kilaj: Po shënojmë pesë vjetorin, të hendikepuar pa shokët tanë çlirimtarë.....	7
KPF dha katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale	10
Vendosen kontejnerët në sheshe dhe në rrugët e qytetit.....	10
Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e saj të radhës	11
Fillon implementimi i projektit “Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatorë”	12
KK shqyrtoi raportin e auditorit për vitin 2011	13

Nga mbledhja e Këshillit të drejtorëve

Pritet të realizohen dhjetëra projekte gjatë këtij viti

Malishevë, 4 shkurt

Në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, i udhëhequr nga z.Isni Kilaj, Kryetar i Komunës së Malishevës, u bë e ditur se gjatë vitit 2013, pritet të realizohen dhjetëra projekte të ndryshme, në infrastrukturë dhe fusha tjera, si bujqësia, kultura, dhe të tjera.

“Jemi në fazën e përgatitjes së projekteve dhe presim që gjatë këtij viti të investojmë në infrastrukturën rrugore, në shumë fshatra të Malishevës, pastaj në shkolla, ujësjellës dhe projekte tjera në infrastrukturën e përgjithshme, si nga buxheti komunal, ashtu nga donacione tjera” tha kryetari Kilaj.

Kryetari Kilaj, po ashtu bëri të ditur se do të ketë projekte edhe në fushën e bujqësisë, pastaj në kulturë, përderisa kërkoi angazhim të shtuar për përgatitjen e fushatës për spërkatjen selektive të zonave endemike, kundër rriqrave, si masë parandaluese kundër infektimit nga ethet hemorragjike, si dhe për hartimin e planit për dezinfektimin e qytetit dhe zonave tjera të caktuara.

Në këtë mbledhje, u diskutua edhe çështje të tjera të punës së Qeverisë Komunale të Malishevës.

U prezantua Plani Zhvillimor i Komunës së Malishevës

Malishevë, 7 shkurt



Sot në Malishevë, është bërë prezantimi publik i draftit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), gjegjësisht, faza e parë dhe faza e dytë e këtij plani, ku është hartuar draft profili, si dhe vizioni, parimet dhe objektivat e zhvillimit komunal, i

punuar nga ekipi punues komunal, në bashkëpunim me UNHABITAT-in.

“Gjatë këtyre viteve në Malishevë, janë bërë ndryshime të mëdha, në aspektin e infrastrukturës dhe zhvillimit të përgjithshëm të komunës, dhe tash kërkohet të hartohet një plan në mënyrë profesionale nga ekspertët e të gjitha fushave. Ky plan është shumë i rëndësishëm në zhvillimin urban dhe zhvillimin e përgjithshëm të Komunës së Malishevës, dhe në të njëjtën kohë për ruajtjen e hapësirës dhe ruajtjen e



trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Ky plan është për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës”, tha në fjalën e hapjes së këtij prezantimi publik, i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj, i cili edhe i falënderoi ekipin punues dhe UNHABITAT-in, për hartimin e PZHK-së.

“Jam shumë e kënaqur me punën në procesin e hartimit të PZHK-së dhe e falënderoi kryetarin e Malishevës dhe ekipin punues në hartimin e këtij plani”, tha Krystyna Galezia, kryesuese e zyrës së UNHABITAT-it në Kosovë, në fjalën e saj me këtë rast. Ajo, më pas e vlerësoi lartë punën e bërë, si një nevojë e madhe për zhvillimin e përgjithshëm të Malishevës. “Malisheva, ka popullatë të re dhe aktive dhe ky është burimi më i madh i implementimit të PZHK-së”, tha znj. Galezia, e cila me pa si përmendi disa nga fushat ku duhet të orientohet zhvillimi i Malishevës, siç janë bujqësia dhe turizmi, si dy burime kyçe të zhvillimit.

Pas fjalimeve hyrëse, në emër të ekipit punues për hartimin e PZHK-së, prezantimin e bëri z.Ximi Osmani, i cili e prezantoi gjendjen ekzistuese në fushën e zhvillimit hapësinor të komunës, si dhe vizionin, parimet dhe objektivat për zhvillimin e komunës në të ardhmen.

Qëllimi i këtij prezantimi publik, ishte informimi i publikut të gjerë të Malishevës, institucioneve relevante dhe palët e interesit, në lidhje me rrjedhën e procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), si dhe për përmbajtjen e draft profilit të zhvillimit hapësinor në Komunën e Malishevës.

Komuniteti RAE, të integruar mirë në shoqëri

Malishevë, 8 shkurt



Anëtarët e Komiteti për Komunitete (organ i Asamblesë Komunale të Malishevës), z.Hysni Gashi, kryesues i këtij komiteti dhe anëtari nga komuniteti RAE, z.Naser Malisheva, kanë vizituar sot disa familje të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas (RAE), me qëllim të njohjes së drejtpërdrejt me jetën e tyre dhe problemet që ata kanë.

Vizitat janë bërë në fshatin Kijevë, Burim (ish Stapanicë), Banjë dhe Malishevë, të cilat edhe janë të

vetmet vendbanime ku jeton ky komunitet, në territorin e Komunës së Malishevës, dhe bazuar në bisedat e drejtpërdrejta, ky komunitet, është i integruar mirë në shoqërinë tonë dhe nuk kanë probleme etnike, përderisa problemet e tyre, janë të njëjta me problemet që ka shoqëria ku ata jetojnë.

Fëmijët e tyre, vijojnë mësimet në shkollat e këtyre vendbanime dhe nuk kanë probleme me dokumentacion, përderisa disa prej tyre kanë probleme me hapësirën për banim.

Vizitën e sotme të anëtarëve të Komitetit për Komunitete, e ka monitoruar edhe ekipi i OSBE-ës në Malishevë.

Komuna dhe IKSHP diskutojnë për masat parandaluese kundër etheve hemorragjike

Malishevë, 12 shkurt

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot në një takim pune, drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), z.Naser Ramdanin dhe epidemiologun dr.Isuf

Dedushaj, për të diskutuar strategjinë e fushatës së spërkatjes selektive, si masë parandaluese, kundër infektimit nga ethet hemorragjike “krime kongo”, e cila bartet tek njeriu, nga thumbimi i rrigrave.

Kryetari i Malishevës, z. Kilaj dhe drejtori për shëndetësi, z. Skënder Hoti, i kanë njoftuar zyrtarët e IKSHP-së, për angazhimet e Komunës së Malishevës, në luftimin e kësaj endemie në territorin e Malishevës, por në të njëjtën kohë kanë kërkuar nga IKSHP-ja, që në aspektin profesional, të marrin masat për luftimin sa më efikas të rrigrave, si bartës të etheve hemorragjike. “Ne shpresojmë edhe në përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë, në këtë drejtim, në mënyrë që sëmundjes ti jepet një goditje më e fortë”, tha Kilaj, duke kërkuar në të njëjtën kohë edhe angazhimin e IKSHP-së, në aspektin profesional.

Nga ana tjetër, drejtori i IKSHP-së, z. Naser Ramadani dhe epidemiologu z. Dedushaj, kanë çmuar lartë punën e deritanishme të Komunës së Malishevës, për luftimin e kësaj sëmundje, përderisa kanë premtuar edhe angazhimin maksimal të IKSHP-së, në këtë fushë. Sipas, drejtorit të IKSHP-së, z. Ramadani, “Dezinsketimi selektiv, i organizuar nga ana e Komunës së Malishevës, tashmë i ka dhënë efektet e saj, në rënien e numrit të të infektuarve nga ethet hemorragjike, por edhe të thumbimit nga rriqrat”.

Kilaj, Hoti, Ramadani e Dedushaj, kanë diskutuar dhe janë pajtuar për strategjinë e fushatës së spërkatjes selektive, si dhe i kanë nxjerrë disa udhëzime për organizimin e kësaj fushate. Në parim janë pajtuar për organizimin e dy fushatave të spërkatjes së zonave endemike, e para gjatë prillit dhe e dyta, në fund të majit, apo fillim të qershorit, nëse këtë ju mundësojnë kushtet atmosferike, përderisa kësaj fushate, do ti paraprijnë fushatat e vetëdijesimit. Po ashtu, me insistimin e komunës, të gjithë janë pajtuar që fushata e këtij viti, të jetë më e gjerë, në aspektin e angazhimit të kapacitete njerëzore, por edhe në aspektin profesional, nga ana e institucioneve përgjegjëse, siç është IKSHP-ja.

Drejtori i IKSHP-së, z. Naser Ramadani, ka bërë të ditur, se ka kërkuar nga ana e ministrisë mbështetje, për fushatën e spërkatjes së zonave endemike.

U prezantua draft plani hapësinor për “Ujëvarat e Mirushës”

Malishevë, 15 shkurt



Organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), gjegjësisht nga Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës dhe Instituti për Planifikim Hapësinor, sot në Malishevë, është prezantuar Draft Plani Hapësinor për Monumentin e Natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës”.

Fillimisht këtë prezantim e përshëndeti, zëvendës ministri i MMPH-së, z.Shpëtim Rudi, i cili e

vlerësoi lartë punën e bërë nga ekipi punues, për hartimin e këtij plani dhe tha se “përkrahja e ministrisë, do të jetë maksimale”. “Mundemi dhe duam ta ndryshojmë vendin tonë”, tha zv/ministri Rudi.

Ndërsa Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, pasi e përshëndeti këtë prezantim, tha se “ky projekt, edhe pse ndoshta pak i vonuar, megjithatë natyra në atë pjesë nuk është degraduar dhe besoj që hartimi i ligjit do ta mbronte edhe më shumë këtë pjesë”. “Uroj në hartimin dhe zbatimin sa më të shpejtë të këtij plani”, tha në fund Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj.

Pas këtyre fjalimeve, koordinatori i projektit, z.Besim Gollopeni, e ka prezantuar draft planin e punuar nga ekipi punues, për Monumentin e Natyrës me rëndësi të veçantë “Ujëvarat e Mirushës”, hapësirë e cila përfshin tri komuna, Klinës, Malishevës dhe Rahovecit.

Kjo hapësirë, e shpallur si zonë me rëndësi të veçantë, ka një hapësirë prej rreth 600 hektarësh, me një lartësi mbidetare prej 600 metrave, me 12 ujëvara dhe liqene tjera të vogla, përderisa ka një florë dhe faunë të pasur, e cila duhet të ruajtur, bashkë me peizazhin e kësaj hapësire.

z.Gollopeni, prezantoi gjendjen e parkut, rolin, profilin e zhvillimit hapësinor të parkut, vizioni, parimet, caqet, kornizën e zhvillimit hapësinor dhe strategjinë e zhvillimit hapësinor, kurs e i tërë projekti, pritet të kushtoj rreth 30 milion euro, ndërsa parashihet që të ruhet edhe hapësira, përreth vijës kufizuese të parkut.

Malisheva, shënoi pesë vjetorin e Shtetësisë së Kosovës

Kilaj: Po shënojmë pesë vjetorin, të hendikepuar pa shokët tanë çlirimtarë

Malishevë, 16 shkurt



Komuna e Malishevës, në kuadër të shënimeve të pesë vjetorit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, ka organizuar një varg aktivitete, ndërsa sot, janë bërë nderime tek shtatorja e Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe në varrezat e dëshmorëve të kombit, në Malishevë dhe Kleçkë, përderisa aktivitetet e sotme, janë përmbyllur me një koncert festiv në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” në Malishevë.

Në fjalimin e mbajtur, me këtë rast, i pari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka thënë se “edhe këtë përvjetor, po e shënojmë të hendikepuar, pasi në mesin tonë nuk gjinden bashkëluftëtarët dhe çlirimtarët, Fatmir Limaj me shokë, të cilët po mbahen padrejtësisht në burgjet e EULEX-it”.

Në vazhdim, fjalimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, i mbajtur në manifestimin qendror në Malishevë:

Malishevë dt. 16 shkurt 2013

Të nderuara familje të dëshmorëve, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, të nderuar anëtarë të kuvendit, të nderuar mysafir dhe ju pjesëmarrës të këtij kremtimi;

Jam i nderuar të ju uroj në pesë vjetorin e shtetit të Kosovës, por edhe njëherë si shumë përvjetor të tjerë, me keqardhje, duhet ti kujtojmë edhe ata të cilët po mbahen padrejtësisht në burgjet e EULEX-it, shokët tanë, çlirimtarët tanë, Fatmir Limajn me shokë.

Sidoqoftë, jemi mbledhur sot këtu që të festojmë pesë vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, akt ky i cili kurorëzoi ëndrrat dhe aspiratat e popullit tonë që heroikisht gjatë tërë historisë u bëri ballë sfidave për të kurorëzuar më në fund ëndrrat dhe aspiratat e tij.



Ne edhe sot në këtë ditë të shënuar përkulemi para aktit madhorë të flijimit të komandantit Legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij, përkulemi para të rënëve të të gjithë brezave që janë më meritoret për shtetin e Kosovës.

Pesë vjet pas shpalljes së Pavarësisë, Deklarata e Pavarësisë e shpallur nga kryeministri Hashim Thaçi dhe e nënshkruar nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit mbetet akti më i rëndësishëm juridik pasi si i tillë zanafillën e kishte në historinë e lavdishme qindra vjeçare të popullit tone nga të gjitha trevat shqiptare.

Të nderuar të pranishëm;

Pesë vite pavarësi janë pak por ne tashmë jemi dëshmitarë të ndryshimeve rrënjësore pasi Kosova e njohur nga rreth 100 shtetet më të fuqishme të botës është bërë faktor stabiliteti dhe ajo po bëhet pjesë e asaj së cilës i përket gjeografikisht - Evropës së qytetëruar, Aleancës së Atlantikut të Veriut si dhe organizatave tjera më të fuqishme të botës.

Ndryshimet në këtë pesë vjetor të pavarësisë si kudo po i vërejmë edhe në Malishevë, në komunën e cila Kosovës i dha shumë. Këto ndryshime po i vërejmë në jetën më të mirë të qytetarit, në rrugët tona të reja, ndërtesa të reja banimi, në më shumë kujdes për njerëzit në nevojë si dhe mundësi më të mira për të rinjtë tanë.

Krahas të arriturave të tjera, vetëm 2-3 muaj më parë, u lëshua në përdorim aksi i pestë i rrugës së kombit e cila përshkon territorin e kësaj komune dhe realizon ëndrrën e madhe të shqiptarëve, e bënë realitet amanetin e dëshmorëve që Kosova krahas lidhjes së përhershme shpirtërore me Shqipërinë të ketë edhe lidhjen e përhershme fizike.

Ky synim u bë realitet dhe ky realitet i krijuar i hap rrugë ëndrrës së madhe TË BASHKIMIT KOMBËTAR që ishte synim i të gjithë brezave.

Të nderuar të pranishëm;

Ne po lëvizim sigurt në këtë rrugë, po lëvizim drejt rezultateve më të mëdha dhe synimit tonë legjitim për një të nesërme edhe më të mire dhe në këtë drejtim të punojmë të gjithë së bashku për Pavarësinë, për veten tonë, për familjet tona, për Kosovën tonë.

JU FALEMINDERIT DHE GEZUAR DITA E PAVARËSISË

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) mbajti mbledhjen e XXX

KPF dha katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale

Malishevë, 19 shkurt

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), mbajti sot mbledhjen e XXX (të dytën për këtë vit), i udhëhequr nga kryesuesi i Asamblesë Komunale, z.Ragip Begaj, ka dhënë katër rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, e cila pritet të mbahet gjatë këtij muaji.

Për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, anë dhënë këto rekomandime: Raporti i Auditorit të pavarur për Komunën e Malishevës për vitin 2011, pastaj Raporti i punës së Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2012-2013. Po ashtu për mbledhjen e ardhshme, janë rekomanduar për KK, edhe bartja e mjeteve nga viti 2012 në vitin 2013, që ka të bëjë me të hyrat vetanake për dy muajt e fundit të vitit 2012 si dhe kërkesa e Kryetarit të Komunës, për shqyrtimin e draft statutit për Palestrën Sportive “Habib Zogaj” në Malishevë.

Në këtë mbledhje, janë diskutuar edhe çështje të tjera, me të cilat merret Komiteti për Politikë dhe Financa.

Vendosen kontejnerët në sheshe dhe në rrugët e qytetit

Malishevë, 26 shkurt

Falë bashkëpunimit të mirë mes Komunës së Malishevës dhe programit të USAID-it, “Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive” (DEMI), është bërë e mundur vendosja e kontejnerëve të vegjël në disa pjesë të qytetit të Malishevës, duke rritur kështu cilësinë për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.



Ky projekt i realizuar mes Komunës së Malishevës dhe USAID-it, është në kuadër të DEMI programit, me saktësisht, në kuadër të rritjes së ofrimit të Shërbimeve Komunale për qytetarët. I tërë projekti ka kushtuar rreth 11

mijë euro, ku mbi 7 mijë e pesëqind euro, janë dhënë nga USAID, ndërsa pjesa tjetër është financuar nga komuna.

Deri më tani janë vendosur 55 kontejner, kryesisht në Parkun e Qytetit dhe në pjesën e qendrës së qytetit, ku edhe frekuentimi i qytetarëve, është më i madh. “Projekti, është ndër më të mirët të realizuar në çdo aspekt, dhe vendosja e kontejnerëve, ishte një domosdoshmëri”, tha drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, z.Alban Kastrati.

Sipas drejtorit Kastrati, synim i drejtorisë, është vendosja e kontejnerëve edhe në rrugët tjera të qytetit, sidomos, përgjatë rrugës “Rilindja Kombëtare”, pasi frekuentimi i numrit të qytetarëve, është i madh dhe është shumë e nevojshme vendosja e kontejnerëve.

“Vendosja e këtyre kontejnerëve, ka qenë e domosdoshme, pasi kontejnerët e mëdhenj janë larguar nga rrugët, sepse nuk kanë qenë funksional dhe janë zëvendësuar me qese najloni, të cilat grumbullohen me orar të caktuar, ndërsa kontejnerët e vegjël, janë në shërbim të kalimtarëve”, tha drejtori Kastrati.

Komiteti për Komunitete, mbajti mbledhjen e saj të radhës

Malishevë, 27 shkurt

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të dhjetën me radhë, ku janë njoftuar lidhur me vizitat që dy nga anëtarët e këtij komiteti, ju kanë bërë familjeve të komunitetit RAE, të cilët jetojnë në Komunën e Malishevës.

Komiteti për Komunitete, kërkoi që të ndihmohen dy familje të komunitetit RAE, të cilat jetojnë në kushte të rënda sociale, për këtë qëllim do të kërkojnë nga organizatat humanitare që të ndihmohen këto familje.

Po ashtu në këtë mbledhje, kanë diskutuar edhe për vizitat që ky komitet, planifikon t’ju bëjë organizatave jo qeveritare në Komunën e Malishevës, të cilat merren me komunitete të caktuara të shoqërisë, më saktësisht, Qendrës Rehabilituese “HANDIKOS” në Malishevë dhe Kryqit të Kuq në Malishevë.

Vizitat këtyre OJQ-ve, planifikohet të mbahen me datën 11 mars.

Fillon implementimi i projektit “Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore”

Malishevë, 28 shkurt



Sot edhe zyrtarisht, tetë punëtorë të angazhuar në projektin e përbashkët të Komunës së Malishevës dhe Caritas Kosova, i kanë nënshkruar kontratat e punës, të cilët do të angazhohen për një vit, në projektin për “Përkujdesje shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore”, në territorin e Komunës së Malishevës. Kontratat janë nënshkruar mes drejtorit gjeneral të Caritas Kosova, Don Viktor Sopi dhe punëtorëve shëndetësorë të angazhuar në këtë projekt.

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, pasi ju uroj mirëseardhje dhe e falënderoi drejtorin e Caritas Kosova, për mbështetjen në realizimin e këtij projekti, i uroi edhe punëtorët e angazhuar në projekt. “Bashkëpunimi dhe menaxhimi i këtij projekti do të jetë i duhur, ndërsa juve ju dëshiroj suksese në punën tuaj dhe ofrim të shërbimeve sa më të mira për qytetarët”, ju ka thënë Kryetari Kilaj, tetë punëtorëve të angazhuar në projekt.

“Puna juaj është në shërbim të qytetarëve dhe përfitimi është i personave që jetën e kalojnë të vetmuar”, ju tha punëtorëve, duke i inkurajuar për punë, drejtori gjeneral i Caritas Kosova, Don Viktor Sopi. “Këto politika sociale, i kanë të gjitha vendet e zhvilluara, ndërsa tek ne si shtet i ri, ka edhe defekte në realizimin e këtyre politikave, por Caritas Kosova, s bashku me mekanizmat e Komunës së Malishevës, do t’ju mbështes në punën tuaj”, tha Don Viktor Sopi.

Edhe drejtori komunal për shëndetësi, z.Skënder Hoti, pasi e falënderoi përfaqësuesin e Caritas Kosova, tha se “me këtë projekt, për një vit, praktikisht edhe janë sistemuar tetë familje, pasi këta tetë persona do të jenë të angazhuar në këtë projekt”.

“Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore”, është projekt ti përbashkët që realizohet mes Komunës së Malishevës dhe Caritas Kosova, i cili do të zgjat një vit, ndërsa qëllim ka ofrimin e shërbimeve shëndetësore permanente, për familjet me anëtar të sëmurë dhe të moshuar, të cilat jetojnë në zonat rurale, si dhe ngritjen e nivelit të kujdesit shëndetësor dhe ambulator, duke angazhuar staf mjekësor në kuadër të QKMF-së në Malishevë.

Asambleja Komunale mbajti mbledhjen e radhës

KK shqyrtoi raportin e auditorit për vitin 2011

Malishevë, 28 shkurt



Asambleja Komunale e Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, ku janë trajtuar disa çështje, siç ishte raporti i Auditorit të Pavarur për Komunën e Malishevës, për vitin 2011, raportin e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë, të vitit shkollor 2012/2013, si dhe bartjen e mjeteve nga viti 2012 në vitin buxhetor 2013.

Pas shqyrtimit të raportit të Auditorit të Pavarur, për Komunën e Malishevës, për vitin 2011, Asambleja Komunale, pas shqyrtimit të kërkesës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe sqarimeve të dhëna nga drejtori i kësaj drejtorie, z.Vesel Krasniqi, me shumicë të votave, ka miratuar këtë kërkesë, e cila ka të bëjë me mjete nga të hyrat vetanake të komunës, kryesisht në dy muajt e fundit të vitit 2012, të cilat për shkak të procedurave, nuk mund të futen në buxhet, por kalojnë në buxhetin komunal të vitit në vijim.

Para këshilltarëve komunal, ka raportuar edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, z.Isuf Morina, lidhur me përfundimin e gjysmë vjetorit të parë, të vitit shkollor 2012/2013, gjegjësisht gjysmë vjetorin e parë të këtij viti shkollor.